

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1463 / Prot.
8

Vlorë më, 21 . 5 . 2025

VENDIM

Nr. 61, datë 21.05.2025

PËR
MIRATIMIN RREGULLORES PËR KËSHILLIN STUDENTOR
TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe referuar propozimit të Sektorit Juridik ardhur me shkresë nr.1409, prot, datë 14.05.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 21.05.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren e Këshillit Studentor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha strukturat akademike, ndihmësakademike dhe administrative në UV.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ





S. A



SA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1409 Prot.Vlorë më, 14 /05/2025

RELACION

Në lidhje me draft-rregulloren e Këshillit Studentor të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

REKTORES SË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE
PROF.DR. AURELA SALIAJ

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 99 "Këshillat e studentëve", studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë janë organizuar në këshillë studentor në nivel institucioni. Në kuadër të funksionimit të tij, Këshilli Studentor ka hartuar një draft-rregullore si një instrument shumë të rëndësishëm që ndihmon në drejtimin dhe funksionimin e brendshëm të këtij Këshilli. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë mënyrën si është i ndërtuar ky këshill, si mbledhet, si zhvillohen mbledhjet, si merren vendimet (me shumicë, unanimitet, etj.), si propozohen çështjet dhe si votohet për to.


Draft-rregullorja është miratuar nga Këshilli Studentor dhe ka kaluar për kontroll pranë Sektorit Juridik.

Pas kontrollit nga Sektori Juridik, propozohet që rregullorja e Këshillit Studentor të kalojë për miratim në Senatin Akademik.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËS SEKTORI

Julita SHABANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KËSHILLI STUDENTOR

Nr. _____ Prot.

Datë, _____._____.2025

RREGULLORE E KËSHILLIT STUDENTOR

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KËSHILLI STUDENTOR

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Këshilli Studentor i UV-së miratoj Rregulloren si më poshtë :

KREU I

DIZPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

Këshilli Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (KSUIQV) i kryen funksionet e tij në përputhje me nenin 99 të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 74 të Statutit të "Universitetit Ismail Qemali" Vlorë dhe në përputhje me rregulloren "Për zgjedhjen e këshillave studentorë" në UV.

Neni 2
Qëllimi


- 1.Qëllimi i Këshilli Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (KSUIQV) është të përfaqësojë interesat e studentëve. Këshilli Studentor luan një rol thelbësor në jetën akademike dhe sociale të studentëve në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të studentëve, nxitjen e pjesëmarrjes studentore në aktivitete arsimore, kulturore, sportive dhe sociale.
 - 2.Krijimin e një mjedisi më të mirë studimi, përmes bashkëpunimit me stafin akademik dhe administratën e Universitetit.
 - 3.Organizimin e debateve, trajnimeve dhe aktiviteteve informuese, që ndihmojnë zhvillimin personal dhe profesional të studentëve.
- Mbledhjen dhe përcjelljen e shqetësimeve të studentëve te instancat përkatëse të universitetit.

KREU II

STRUKTURA DHE ANËTARËSIMI

Neni 3
Përbërja e Këshilli Studentor i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (KSUIQV)

- 1.Këshilli Studentor i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë është organ kolegjal, i përbërë nga 13(trembëdhjetë) student të zgjedhur në 4(katër) njësitë kryesore përbërëse të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KËSHILLI STUDENTOR

2. Çdo njësi kryesore do të ketë nga 3 (tre) përfaqësues prej të cilëve 2(dy) përfaqësues nga programi Bachelor dhe profesional, 1(një) përfaqësues nga programi Master, në rang Universiteti 1 (një) përfaqësues do të jetë nga programi Doktoraturë.
3. Këshilli Studentor zgjidhet cdo dy vjet, nga votat e studentëve dhe mbështeten në legjislacionin në fuqi.
4. Anëtarët e Këshillit Studentor janë të detyruar të angazhohen aktivisht në përfaqësimin e interesave të studentëve.

Neni 4

Kryesia e Këshillit Studentor

1. Këshilli Studentor, në mbledhjen e tij të parë e zgjedh kryetarin, nënkryetarin dhe sekretarin.
2. Kryetari, nënkryetari dhe sekretari përbëjnë kryesinë e Këshillit Studentor. Kryesia e Senatit Akademik kujdeset për mbarëvajtjen dhe funksionimin normal të këshillit.
3. Sekretari i Këshillit Studentor, është përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit, organizimin e mbledhjeve dhe mbajtjen e procesverbaleve. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen e vulës së Këshillit Studentor i Universitetit "Ismael Qemali", Vlorë (KSUIQV).

Neni 5

Kryetari i Këshillit Studentor

1. Në mbledhjen e parë të Këshillit Studentor marrin pjesë të gjithë anëtarët të shpallur fitues.
2. Në këtë mbledhje të gjithë anëtarët zgjedhin me votim të fshehtë Kryetarin e Këshillit Studentor të UV-së, i cili ka një mandat 2 –vjeçar.

Neni 6

Funksionet e Kryetarit të Këshillit Studentor

1. Kryetari i Këshillit Studentor ka një mandat 2-vjeçar dhe ushtron kompetencat e veta deri në zgjedhjen e një kryetari të ri.
2. Përfaqëson çdo student në komunikimet me drejtuesit e njësive kryesore, universitetit dhe institucione të tjera.
3. Përfaqëson Këshillin në marrëdhënie me të tretët.
4. Nis dhe udhëheq fushata për përmirësimin e kushteve në Universitet; nga mjedisi, oraret, përmirësimi i kushteve në mësimdhënie dhe çështje të tjera me rëndësi për studentët.
5. Koordinon projekte si aktivitete sociale, humanitare, debate publike, ditë kulturore.
6. Përfaqëson zërin e Studentëve në aktivitete publike, media lokale, takime me figura të rëndësishme dhe projekte kombëtare.
7. Siguron që çdo vendim, buxhet apo projekt të jetë i qartë dhe i drejtë pa favorizime apo dyshime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KËSHILLI STUDENTOR

8. Lë pas një model të fortë udhëheqjeje, struktura funksionale dhe një frymë pozitive që motivon gjeneratat e ardhshme.
9. Kryeson mbledhjet me studentët si dhe me Këshillin Studentor.
10. Monitoron vendosjen në zbatimin të vendimeve të marra prej Këshillit Studentor.
11. Mban përgjegjësi për administrimin e financave të vendosura në dispozicion për zhvillimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të Këshillit.
12. Është përgjegjës për marrjen e masave disiplinore për shkelje të disiplinës së anëtarëve të Këshillit, dhe propozon heqjen e mandatit në rast të shkeljeve të rënda ose të përsëritura.

Neni 7

Funksionet e Këshilli Studentor


1. Këshilli Studentor ka për detyrë të përfaqësojë studentët në mbledhjet akademike të njësive kryesore dhe Universitetit.
2. Këshilli ka të drejtën të organizojë aktivitete kulturore, edukative dhe shoqërore për studentët e katër fakulteteve.
3. Këshilli trajton të gjitha problematikat që kanë studentët gjatë veprimtarisë akademike që ndikojnë në procesin mësimor.
4. Është përgjegjës për parashtrimin e kërkesave dhe sugjerimeve për përmirësimin e kushteve të studimit dhe jetës studentore në organet drejtuese të universitetit.
5. Këshilli Studentor informon studentët për aktivitetet dhe projektet që organizon.
6. Këshilli studentor duhet të ketë pjesëmarrje në mbledhjet në të cilat trajtohen problematika në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e studentëve.
7. Këshillit me kërkesë të studentëve organizon takime me drejtuesit e njësive kryesore për problematika të ndryshme që mund të dalin gjatë veprimtarisë akademike.
8. Kërkesa hartohet prej studentëve dhe të dorëzohet pranë Sekretarit të Këshillit i cili ja përcjell Kryetarit për diskutim.
9. Këshilli të ketë një ambient për të zhvilluar veprimtarinë tij.
10. Dorëzimi i kërkesave, ankesave, njoftimeve, apo shkresave të tjera, do të dorëzohen pranë Sekretarit të Këshillit Studentor.
11. Ambienti i përshtatur për ushtrimin e aktivitetit të Këshillit Studentorë do të jetë i disponueshëm nga dita e hënë deri ditën e premte, prej orës 08:00 deri në orën 13:00.
12. Këshilli Studentor për veprimtaritë që do të zhvilloj do të financohet nga Universiteti.

KREU III

Mbledhja dhe Votimi në Këshill

Neni 8

Mbledhjet e Këshillit Studentor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KËSHILLI STUDENTOR

1. Këshilli Studentor mbledhet me nismën e Kryetarit. Në rast mungese objektive të Kryetarit, mbledhjet thirren dhe kryesohen nga nënkryetari i Këshillit.
3. Këshilli Studentor mban mbledhje të rregullta çdo 2 javë për të shqyrtuar çështjet të rendit të ditës dhe për të planifikuar veprimtari apo aktivitete në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij.
3. Me kërkesë të Kryetarit të Këshillit ose të 2/3 të anëtarëve të Këshillit, mund të shqyrtohen dhe çështje të tjera të cilat nuk janë parashikuar në rendin e ditës.
4. Mbledhjet e Këshillit nuk janë të hapura, por në raste përjashtimore, çdo student që dëshiron të jetë i pranishëm duhet t'ja komunikoj kërkesën e tij dhe arsyet, Sekretarit të Këshillit, i cili më pas ja përcjell për miratim Kryetarit të Këshillit.
5. Çdo anëtar i pranishëm në mbledhje ka të drejtën e fjalës për çdo çështje, të drejtën e fjalës e jep Kryetari sipas rradhës së kërkesës.
6. Kryetari ja ndërpret fjalën anëtarit të Këshillit në rast mosmarrëveshje të ndryshme me anëtarët e tjerë të këshillit.
7. Në rast se mosmarrëveshja rrezikon funksionimin normal të mbledhjes, Kryetari mund të vendosë të ndërpres mbledhjen për 30 minuta ose ta shtyjë atë për një ditë tjetër.
8. Në çdo mbledhje do të mbahet procesverbali i mbledhjes nga Sekretari, duke pasqyruar në të çdo çështje të diskutuar në rendin e ditës.
9. Në përfundim të mbledhjes, procesverbali do të firmoset prej Kryetarit dhe Sekretarit.

Neni 9


Njoftimi i mbledhjeve

1. Ditët për zhvillimin e mbledhjeve dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet paraprakisht prej sekretarit, minimumi 24 ore përpara, anëtarëve të Këshillit Studentor dhe përjashtimisht edhe studentëve që kanë kërkuar të jenë të pranishëm.
2. Njoftimi do të realizohet nëpërmjet postës elektronike.

Neni 10

Vendimarrja

1. Vendimet e marra nga Këshilli Studentor janë të detyrueshme për zbatim.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash, kur të pranishëm në mbledhje janë shumica e anëtarëve të Këshillit Studentor përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore.
3. Votimi është i hapur, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga Kryetari ose 2/3 e anëtarëve të Këshillit dhe në rastin e votimeve nominale.
4. E drejta e votës ushtrohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk është e delegueshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KËSHILLI STUDENTOR

KREU IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Humbja e mandatit

1. Mandati i Anëtarit të Këshillit Studentor përfundon në rastet kur :
 - studenti, anëtar Këshilli, përfundon studimet,
 - jep dorëheqjen,
 - kryen shkelje të rëndë të disiplinës apo shkelje të përsëritur të rregullores,
 - nuk zbaton vendimet e Këshillit Studentor,
 - nuk merr pjesë në 3 mbledhje rradhazi pa shkaqe të arsyeshme
2. Vendimi për marrjen e masës disiplinore merret me shumicë të cilësuar prej 2/3 të anëtarëve të Këshillit Studentor.
3. Vendi i mbetur vakant do të zëvendësohet nga kandidati i renditur në rradhë pas tij, referuar procesit zgjedhor të Këshillit Studentor.


Neni 12
Ndryshimet e Rregullores

1. Çdo ndryshim ose shtesë në këtë rregullore do të bëhet vetëm me vendim të Këshillit Studentor, me shumicë të cilësuar prej 2/3 të gjithë anëtarëve të, dhe me miratim të Senatit Akademik të Universitetit.
2. Çdo ndryshim do të publikohet dhe do t'u komunikohet studentëve të Universitetit.

KRYETARI I KËSHILLIT STUDENTOR
ALTEA HOXHAI

Anëtarë:

1. Algisa Saliaj
2. Fabion Elmazi
3. Flovjana Korçari
4. Fjoralba Latifaj
5. Kevin Bino
6. Emili Osmani
7. Sabina Malaj
8. Katerina Vruzhaj
9. Eristina Sinanaj
10. Leandro Grabovaj
11. Xhuliano Mahilaj
12. Anila Lula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 15.06.2025

Drejtuar:
Senatit Akademik

REKTORI

Prof. Dr. Aurela Saliq

